



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, ~~20.10~~ 2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.10.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "TREGTIA" SHPK' për aktivitetin: "PPP PARKINGU NENTOKESOR TE FAKULTETI FILOLOGJIK NE PRISHTINE" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-072-512 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "TREGTIA SHPK", e datës 19.10.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " PPP PARKINGU NENTOKESOR TE FAKULTETI FILOLOGJIK NE PRISHTINE" me Nr.616 18 072 512 kundër *Vendimit për refuzimin e tenderit të të njëjtit, respektivisht për eliminimin e tij nga pjesëmarrje e mëtejme në këtë aktivitet.*
2. Aprovohet Vendimi –Njoftimi për tenderuesin e eliminuar i datës: 16.10.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe Departamentit të Prokurimit.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "TREGTIA SHPK " me datë 19.10.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "PPP PARKINGU NENTOKESOR TE FAKULTETI FILOLOGJIK NE PRISHTINE" me numër të prokurimit 616 18 072 512.

Autoriteti Kontraktues, me datë 22.10.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës:

1. Vetëm pretendimi nga pika 2.2 ka të bëjë me arsyet e paraqitura në letrën standarde për kandidatin e eliminuar, pasi që pretendimet tjera nuk kanë të bëjnë me përmbajtjen e të njëjtës. Sa për sqarim në letrën standarde është cekur decidivisht se kandidati nuk ka ofruar dëshmi për kryerjen e një projekti infrastrukturor në vlerën mbi 5,000,000.00 euro dhe poashtu nuk ka ofruar dëshmi për menaxhimin e parkingjeve për tri vite, ndërsa nuk janë kontestuar as qarkullimi financiar e as aftësia për kredimarrje (EBITDA).

Lidhur me pretendimin se kandidati ka realizuar shumë projekte dhe me vlera më të mëdha nga kërkesa i sqarojmë se dëshmi e realizimit nuk është Leja e ndërtimit, por Leja e përdorimit. Lidhur me lejet e përdorimit të dorëzuara i sqarojmë si vijon:

-Në formularin 3.E.2 ju keni paraqitur projektin :Projektimi, Ndërtimi, Financimi i Kompleksit Blloku A 19(01,2B,03,04,05) me vlerën e përgjithshme të ndërtimit 5,379,546.00 €, ndërsa Leja e përdorimit është e lëshuar për Lamelen 01, e që nuk keni dëshmi për kryerjen dhe pranimin zyrtar të katër lamelave tjera dhe kjo nënkupton se vlera e paraparë për ndërtimin e të gjitha lamelave nuk mund të vlej për njerën prej tyre. Leja e përdorimit për një lamelë që e keni dorëzuar në përgjegjen tuaj është me numër 15 e datës 14.01.2015. Leje të përdorimit dhe shfrytëzimit keni dorëzuar edhe për një objekt tjetër-Blloku 21, por me vlerë totale prej 2,653,759.00 € (Leja për shfrytëzim 338 e datës 01 12.2016) e që nuk plotëson kriterin e kërkuar.

Të gjitha dokumentet tjera që i keni dorëzuar kanë të bëjnë me Lejet e ndërtimit dhe nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi për pranimin e atyre objekteve.

2 Lidhur me pretendimet se plotësoni kriteret për menaxhimin e parkingjeve sipas kërkesave të ftesës tonë për kualifikim iu sqarojmë si vijon:

-Kërkesa ka qenë si vijon: Ofertuesi potencial duhet të demonstroj se ka përvojë të mjaftueshme në menaxhimin e punëve operative të objekteve infrastrukturore, ose objekteve komercilae në hapësirë minimum 15,000.00 m<sup>2</sup> së paku tri vite, ose në menaxhimin e parkingjeve me pagesë minimum 500 vendparkime në një lokacion së paku tri vite, ose në menaxhimin e sistemeve të pagesave të objekteve të ngjajshme infrastrukturore së paku tri vite. Ofertuesi potencial duhet të dorëzoj dëshmim se ka përmbushur një ose më shumë se një nga kushtet e përcaktuara më lartë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

-Plotësimi i shtojcës 3.E.2 ti bashkëngjiten referencat apo çertifikatat për kryerje të punëve.

Ua përkujtoj se ju keni dorëzuar kontrata me punëtorët tuaj për menaxhim të parkingjeve dhe atë për menaxhim të parkingjeve në shumë objekte që është e pamundur të bëhet njëkohësisht nga një person dhe asnjë nga vendparkingjet e paraqitura nuk arrin numrin prej 500 vendparkimeve.

Poashtu nuk ka asnjë dëshmi me pronarët e banesave për menaxhim të ndërtesave e as të vendparkingjeve dhe asnjë ndonjë dëshmi tjetër për menaxhim të sipërfaqeve minimum 15,000.00 m<sup>2</sup>, përpos deklaramit tuaj për mirëmbajtje njëvjeçare e që prap nuk është në harmoni me kërkesat tona.

Në bazë të mungesës së dëshmive të paraqitura më lartë konstatoj se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar, respektivisht se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në harmoni me dispozitat ligjore me rastin e refuzimit të përgjegjes tuaj lidhur me pikat e cekura në letrën për eliminim.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij Vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit